

## PLANI DITOR

**Fusha mësimore:** Gjuhë shqipe dhe komunikim

Klasa: II

Kohëzgjatja e orës: 40 min

**Njësia mësimore:** Gramatikë - Të dallojmë foljen gj.shq. f.44- Ushtrime

### Rezultatet e të nxënit :

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të :

\* **Dallojnë foljen si fjalë që tregojnë se ç'bëjnë njerëzit, kafshët, sendet dhe t'i përdorin ato në fjali.**

\* **Gjejnë foljet nga tekstet e mësuara.**

\* **Gjejnë folje të ndryshme dhe të formojnë fjali me to.**

**Qëllimi i të nxënit:**Të ushtrojmë të dallojmë foljen .

Materialet dhe burimet e nevojshme për mësimdhënie / aktivitete

Libri i gjuhës shqipe, fletorja etj.

Përshtatja me nevojat e nxënësve .

Aktivitete që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve.

Procedura e mësimdhënies dhe **plani i vlerësimit**

STRUKTURA E ORËS		TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES
EVOKIM	E	Stuhi mendimesh
REALIZIMI I KUPTIMIT	R	Drta ( Lexim i drejtuar)
REFLEKTIMI	R	Pesëvargësh

Do t'i shenoj dy fjali në tabelë:

**Arta e vogël vizaton shkollën.**

**Miri e hëngri ëmbëlsirën.**

- Ç' bën Arta e vogël?

- Ç' bën Miri?

- Çfarë tregojnë fjalët **vizaton, hëngri** ?

Dhe më pas shënoj në tabelë qëllimin e të nxënit:

**Të ushtrojmë të dallojmë foljen .**

**Pastaj bashkë me nxënës nxjerrim dhe shënoj në tabelë edhe kriteret e suksesit:**

\***Dalloni foljet në një tekst të mësuar.**

\* **Gjeni foljet në tekstin e mësuar.**

\* **Gjeni folje dhe formoni fjali me to.**

Mandej nxënësit do t'i udhëzoj të hapin librat .

Do të kërkoj nga nx. të dallojnë foljet tek mësimi : Edhe Miri i vogël punon.

Pastaj disa edhe do t'i shkruajmë në tabelë. P.sh

Miri lustron këpucët e babait, të nënës dhe të vetat.

Ai i vë të gjitha në radhë.

Miri lidh përparësen dhe nis e bisedon me to: “Hë rrini tani dhe pritni t'ju vi radha!”

Me një leckë u heq baltën , me furçë u fshin pluhurin , pastaj i lyen me bojë një rën pas tjetrës dhe më në fund i lustron derisa të shkëlqejnë si pasqyrë...

Vlerësim në fillim të mësimit

Vlerësim gjatë mësimit

- Sa janë të kuptuar për ju ushtrimet? ( Nxënësit me ngritjen e ngjyrave të semaforit do të tregojnë për kuptimin lidhur me ushtrimet). Vetëvlerësimi – Ngjyrat e semaforit

Pastaj së bashku me nxënës do të punojmë një pesëvargësh për tekstin: Edhe Miri i vogël punon , pasi nga ky tekst kemi marr edhe fjali për të dalluar foljet.

**Miri**

**i vogël**

**i dëgjueshëm**

**lyen**

**lustron**

**punon**

**Miri i vogël lustron këpucët e babait, nënës dhe të vetat .**

**Fëmijë**

**Detyrë shtëpie-** Nxënësit do të punojnë në fletore 5 fjali me folje të ndryshme duke i nënvizuar foljet.

### **Reflektimi :**

Procedurat e mësimdhënies nxënësve u ndihmojnë që konceptet e reja dhe njohuritë e fituara t'i shfrytëzojnë për analizë gramatikore të fjalive.

Gjithashtu u mundëson që të krijojnë një shprehje më të mirë në të shkruarit.

Gjatë aktivitetit kryesor të orës mësimore përmes kriteteve të suksesit duhet të arrijnë realizimin e qëllimit të mësimin.

Përmes detyrës së shtëpisë nxënësit kanë mundësi të përvetësojnë njohuritë e tyre rreth ushtrimeve të punuara në klasë.

Vlerësim pas  
mësimin

## PLANI DITOR

**Fusha mësimore:** Gjuhë shqipe dhe komunikim

Klasa: II

Kohëzgjatja e orës: 40 min

**Njësia mësimore: Të shkruajmë:** Si të kërkojmë falje gj.shq.f.45- Ushtrime

### Rezultatet e të nxënit :

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të :

\* **Plotësojnë një tekst me fjali të paplota.**

\* **Ushtrohen të kërkojnë falje me shkrim.**

### Qëllimi i të nxënit: Të ushtrojmë si të kërkojmë falje .

Materialet dhe burimet e nevojshme për mësimdhënie / aktivitete

Libri i gjuhës shqipe, fletorja etj.

Përshtatja me nevojat e nxënësve .

Aktivitete që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve.

### Procedura e mësimdhënies dhe **plani i vlerësimit**

STRUKTURA E ORËS		TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES
EVOKIM	E	Stuhi mendimesh
REALIZIMI I KUPTIMIT	R	Drta ( Lexim i drejtuar)
REFLEKTIMI	R	Shqyrtim i përbashkët

Pyetja kryesore për fillim: **Nese keni bërë ndonjë gabim si do të kërkonit falje?**

Nxënësit përgjigjen rreth pyetjes kryesore dhe më pas shënojnë në tabelë qëllimin e të nxënit:

Dhe më pas shënojnë në tabelë qëllimin e të nxënit:

**Të ushtrojmë si të kërkojmë falje .**

Mandej nxënësit do t'i udhëzojë të hapin librat .

**Pastaj bashkë me nxënës nxjerrim dhe shënojnë në tabelë edhe kriteret e suksesit:**

\***Plotësoni tekstin me fjali të paplota.**

\***Vazhdoni të plotësoni tekstin.**

\***Gjeni fjali që është dashur të përdorë Ardi.**

\* **Tregoni ndonjë fjali që keni kërkuar falje mësues.**

**Ushtrimi i parë** tek ky ushtrim do të aftësohen nxënësit të plotësojnë një tekst me fjali ku mungojnë fjalë, lidhur me një temë të caktuar.

Ushtrimi i plotësuar paraqitet si vijon:

Mira hapi **cantën** dhe futi brenda **gërshërët, vizoren , lapsat me ngjyra**. Ajo u nis e gëzuar për në **shkollë**. Kur hyri në **klasë**, mësuesja u that ë gjithëve të nxirrnin mjetet e punës. Sa u gëzua Mira, kur pa se nuk i mungonte asgjë.

**Ushtrimi i dytë.** Te ky ushtrim nxënësit aftësohen të kërkojnë falje me shkrim.

Ushtrimin me disa fjali do të shkruaj në tabelë edhe ate me ngjyra të ndryshme.

Vlerësimi në fillim të mësimit

Vlerësimi gjatë mësimit

**Më falni, mësuese . Unë kam harruar sot mjetet e punës.**

**Ju lutem , mësuese , më falni. Unë kam harruar gërshërën.**

**Mësuese, unë kam harruar mjetet e punës së dorës. Më falni, ju lutem.**

**- Sa janë të kuptuar për ju ushtrimet? ( Nxënësit me ngritjen e ngjyrave të semaforit do të tregojnë për kuptimin lidhur me ushtrimet). Vetëvlerësimi – Ngjyrat e semaforit**

**Ushtrimi i tretë. Ky ushtrim ka të njejtin synim si dhe ushtrimi nr. 2.**

**Pra: Mësuese, ju lutem, më falni, se kam harruar fletoren në shtëpi.**

Nxënësve do t'u kërkoj të vendosin vijën përpara fjalëve që thonë Ardi dhe Zana.

**Mandej nxënësit do t'i diktoj diktimin në fund të ushtrimeve.**

**Detyrë shtëpie- Nxënësit do të punojnë në fletore ushtrimin 4.**

### **Reflektimi :**

Procedurat e mësimdhënies nxënësve u ndihmojnë që konceptet e reja dhe njohuritë e fituara t'i shfrytëzojnë për analizë gramatikore të fjalive.

Gjithashtu u mundëson që të krijojnë një shprehje më të mirë në të shkruarit.

Gjatë aktivitetit kryesor të orës mësimore përmes kriteteve të suksesit duhet të arrijnë realizimin e qëllimit të mësimin.

Përmes detyrës së shtëpisë nxënësit kanë mundësi të përvetësojnë njohuritë e tyre rreth ushtrimeve të punuara në klasë.

Vlerësimi  
pas mësimin

## PLANI DITOR

**Fusha mësimore:** Matematikë

Klasa: II

Kohëzgjatja e orës: 40 min

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave dyshifrorë dhe me një numër njëshifror me kalim të numrit 10 f. 41 Mat.

### Rezultatet e të nxënit :

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të :

\* **Gjejnë shumën e saktë duke mbledhur numrat njëshifror me numrat dyshifrorë me kalim të dhjetës.**

\* **Duke zëvendësuar mbledhorin me shumë ,njehsojnë .**

\* **Shprehje me numra i njehsojnë vlerën e tyre në drejtëzen numerike.**

### Qëllimi i të nxënit: Të mësojmë për mbledhja e numrave dyshifrorë dhe me një numër njëshifror me kalim të numrit 10

Materialet dhe burimet e nevojshme për mësimdhënie / aktivitete

Libri i matematikës fletore pune , fletorja ,shpuza, shkumsi etj .

Përshtatja me nevojat e nxënësve .

Aktivitete që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve.

### Procedura e mësimdhënies dhe **plani i vlerësimit**

STRUKTURA E ORËS		TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES
EVOKIM	E	Stuhi mendimesh
REALIZIMI I KUPTIMIT	R	Lexim i drejtuar
REFLEKTIMI	R	Pyetje për diskutim

Vlerësimi në fillim të mësimit

**Aktiviteti I – Do të paraqes në tabelë numrat prej 50 deri në 70 dhe do t’u them : duhet të gjejnë shumën e numrave  $58 + 7$ . Si do të veprojmë ?**

**Nxënësit mendojnë dhe tregojnë mënyra të ndryshme të zgjidhjes. Unë do t’i shënoj të gjitha zgjidhjet e nxënësve në tabelë. Nëse nga zgjidhjet e dhëna nuk është paraqitur mënyra me kalim të 10, atëherë do të pyes :**

-Sa numra duhet shtuar numrit 58 për të formuar numrin 60? ( 2)

-Atëherë kush ja dhuroi numrit 58 edhe dy numra për t’u formuar numrin 60 ? ( 7 )

- Edhe sa mbeten nga numri 7? ( 5)

-Po nëse , numrit 50 të formuar më herët i’a shtojmë edhe numrin 5, sa bëhen gjithsejt? ( 65 )

**Pra ,**

$$58 + 7 = 58 + ( 2 + 5 ) = ( 58 + 2 ) + 5 = 60 + 5 = 65.$$

Dhe më pas shënoj në tabelë qëllimin e të nxënit:

**Të mësojmë për mbledhja e numrave dyshifrorë dhe me një numër njëshifror me kalim të numrit 10**

Pastaj bashkë me nxënës nxjerrim dhe shënoj në tabelë edhe kriteret e suksesit:

\***Kryeni mbledhjen e numrave dyshifrorë dhe numrit njëshifror me kalim të numrit 10.**

\***Njehsoni duke zëvendësuar mbledhorin me shumë.**

\***Pasi të njehsoni, zgjidhjet i vijëzoni.**

Vlerësimi  
gjatë  
mësimit

Mandej nxënësit do t'u fillojnë të plotësojnë barazimet e dhëna në detyrë, do t'i pyes

#### **Detyra 1.**

- Në skemën e dhënë në shembullin e parë janë dhënë numrat.  $69 + 6$
- Çfarë do të bëni ? ( Parashtrimi i pyetjeve )
- Si do të ndani ( zbërtheni ) numrin  $6$  ? (  $1 + 5$  ).
- A është më lehtë për ju nëse e gjeni shumën e barazimit  $69 + 6$  , apo në mënyrën e paraqitur si në libër, me skemë?
- Përse ?

#### **Detyra 2.**

- Çfarë po shihni në detyrën 2? ( boshtin numerik.)
- Banoni ( tullumbacja ) tregon numrin  $67$ .
- Ai duhet të fluturon deri te numri  $70$ .
- Sa numra kaloi ? (  $3$  ) . Por, baloni duhet të lëviz prapë. Edhe s numra duhet të tjerë kaloi? (  $5$  )
- Si i gjetët ? (  $8 = 3 + 5$  ).

Vizatoni balonin aty ku arriti dhe shënوني numrin në të? (  $75$  )

- Sa është i kuptuara për ju ushtrimi? ( Nxënësit me ngritjen e ngjyrave të semaforit do të tregojnë për kuptimin lidhur me ushtrimin . )

#### **Detyra 3.**

Nxënësit njehsojnë individualisht detyrën 3, unë do vëzhgoj dhe ndihmoj nxënësit që kanë nevojë. Vlerësoj punën e tyre pas zgjedhjes.

- Sa është i kuptuara për ju ushtrimi? ( Nxënësit me ngritjen e ngjyrave të semaforit do të tregojnë për kuptimin lidhur me ushtrimin . )

#### **Detyra 4.**

Unë do të tregoj se zgjidhjet e çdo barazimin janë në çantë përfundi tyre. Nxënësit punojnë në dyshe ( çift ) gjejnë shumën dhe poashtu nënvizojnë numrat e dhënë në çantë.

#### **Detyra 5.**

Duke mbledhur mbledhorët e dhënë, nxënësit shumën e gjetur e shënojnë në boshtin numerik aty ku tregon shigjeta.

Ata punojnë individualisht dhe më pas bisedojnë me shokët në grup apo bankë.

**Detyrë shtëpie-** Nxënësit shkruajnë detyrën 4 në fletore .

#### **Reflektimi :**

Procedurat e mësimdhënies nxënësve u ndihmojnë që konceptet e reja dhe njohuritë e fituara t'i shfrytëzojnë për mbledhja e numrave dyshifrorë dhe me një numër njëshifror me kalim të numrit 10.

Kritetet e suksesit janë të lidhura me fazën e realizimit – kuptimit të orës mësimore. Përmes detyrës së shtëpisë nxënësit kanë mundësi të përvetësojnë njohuritë e tyre rreth ushtrimeve të punuara në klasë.

Vlerësimi  
pas mësimit